



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.02.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të komisionit për periudhën 6 shkurt -26 shkurt 2015.
2. Projektligji “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Mark Frroku, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Nard Ndoka,

Mungojnë: Tom Doshi, Fatmir Mediu

Të ftuar:

Ketrin Treska – drejtoreshë në Drejtorinë e Oponencës Ligjore, në Ministrinë e Drejtësisë.
Eljona Bylykbashi – përgjegjëse sektori, në Ministrinë e Drejtësisë.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj - Mirëdita!

Dua t'ju bëj me dije se seanca plenare ka miratuar 3 nënkomisionet, që janë pjesë e këtij komisioni dhe konkretisht janë: Nënkomisioni për Administratën Publike, që përbëhet nga zotërinjtë: Blendi Klosi, Oerd Bylykbashi, Vexhi Muçmataj, Armando Subashi dhe Gent Strazimiri; Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore, që përbëhet nga zotërinjtë: Bashkim Fino, Arben Ristani, Dashamir Peza, Petrit Vasili dhe Eduard Halimi dhe nënkomisioni për Çështjet dhe të Drejtat e Njeriut, që përbëhet nga: zonja Hysi, zoti Muhedini, zoti Majko dhe zonja Caka.

Në rendin e ditës kemi draft-kalendarin e komisionit. Besoj se projekti u është shpërndarë të gjithë kolegëve anëtarë të komisionit.

Ka vërejtje? Gjithsesi ky është një projekt, sepse gjatë javës mund të ketë dhe do të ketë ndryshime.

Zoti Fino, urdhëroni!

(Zoti Fino flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Po, do të biem dakord me...

(Zoti Fino flet pa mikrofon.)

Mund të biem dakord që t'i bëjmë në kuadrin e Nënkomisionit për Qeverisjen Vendore, që janë të gjithë anëtarët e komisionit. Gjithsesi, do ta vendosim sot, besoj dhe do të bëjmë njoftimet.

Jemi dakord? Dakord.

Vazhdojmë me projektligjin "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë". Kemi mbetur te neni 49.

E kam thënë edhe herë tjetër, por, po përsëris, për të qartësuar edhe kolegët, pasi ta kemi mbyllur nen për nen, përpara se ta votojmë në tërësi, do të kenë mundësi të shikojnë një draft-tekst integral, në mënyrë që edhe nëse ka diçka gjatë debateve të ndryshme, mund të mos jetë ajo që duhet të kemi në tekst, t'i diskutojmë.

Nuk do të nxitohemi me këtë projekt, për shkak të rëndësisë që ka, edhe për faktin që po punohet paralelisht me një grup pune për të parë me detaje nen për nen, por edhe se ky është një projekt i hartuar në bashkëpunim me SIGMA-n dhe i monitoruar me shumë kujdes, po nga

SIGMA, në procesin e debatit dhe draftit përfundimtar në komision. Edhe kjo është një arsye tjetër që në fund do të jetë e nevojshme për të marrë një miratim përfundimtar të tekstit integral final edhe nga SIGMA.

Vazhdojmë me nenin 49.

Neni 49/1? Ka vërejtje ministria?

Ketrin Treska – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Për fat të mirë është konsultuar paraprakisht me ministrinë.

Ketrin Treska – Po, është konsultuar.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Faleminderit!

Neni 50, mbetet siç është. Dakord.

Neni 51? Ndryshon vetëm pika 2. Formulohet si vijon... Besoj se nuk ka ndonjë kundërshti, që të mos i lexoj, se janë faqe më faqe këtu dhe është humbje kohe, apo jo? Secili nga kolegët e ka përpara tekstin. Nuk po e lexoj përmbajtjen e tekstit, sepse do të ishte një punë e tepërt.

Atëherë, pika 2 e nenit 51, ndryshon, kurse pika 1 mbetet siç është.

Jeni dakord me ndryshimin e bërë?

Ketrin Treska – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 52, mbetet siç është. Dakord?

Ketrin Treska – Dakord.

Fatmir Xhafaj– Neni 53? Reformulohet fillimi i procedurës administrative.

Jeni dakord?

Ketrin Treska - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 54 i ndryshuar. Jeni dakord?

Ketrin Treska - Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 55, riformulohen pikat 2, 3 dhe 4 dhe shtohet një pikë e re 5. Jeni dakord?

Ketrin Treska - Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 56, fillimi i procedurës administrative nga palët, riformulohet sipas tekstit të paraqitur. Jeni dakord?

Ketrin Treska – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 57, me riformulimin e bërë “e drejta e palëve për njohjen me dosjen”. Jeni dakord?

Ketrin Treska – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 58, “kufizimi i së drejtës së palëve për njohjen me dosjen”. Jeni dakord?

Ketrin Treska – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 59, togfjalëshi “pala apo pala e interesuar”, zëvendësohet me togfjalëshin “të gjitha palët” e riformuluar si vijon te neni 59 “E drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime”. Jeni dakord?

Ketrin Treska – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 60, “Detyrimi i vlerësimit”. Në nenin 60, togfjalëshi “ palëve apo palëve të interesuara” zëvendësohet me togfjalëshin “e të gjitha palëve” dhe riformulohet si vijon. Jeni dakord?

Ketrin Treska – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 61 mbetet pak a shumë siç është, njesimi i akteve të veta, por në pikën 5 pas fjalëve “ditë”, hiqet fjala “pune”. Jeni dakord?

Ketrin Treska – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 62, “njësimi në lidhje me dokumentet elektronike”. Jeni dakord?

Ketrin Treska – Dakord

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 63, mbetet siç është.

Neni 64, vërtetimi i nënshkrimeve kudo ku është përdorur togfjalëshi “organ zyrtar” zëvendësohet me “organ publik” dhe kudo ku është përdorur fjala “zyrtar referuar personave” zëvendësohet me “nëpunës publik”. Jeni dakord?

Ketrin Treska - Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kreu i V titullohet “Afatet”, referuar modelit të ndjekur nga SIGMA. Pas kreut V, shtohet seksioni i parë i titulluar “Afatet e veprimeve procedurale për palët, shtyrja dhe rivendosja në afat”.

Pika 2. Dakord? Dakord.

Pika 2 te neni 65, “Përcaktimi dhe shtyrja e afateve procedurale”. Pika 2 riformulohet si vijon: “përshtatet me versionin fillestar të SIGMA-s”, neni 36 pika 2. Dakord? Dakord.

Neni 66 “Rivendosja në afat”, pika 2 sugjerohet të riformulohet dhe pjesa tjetër të mbetet siç është. Kush është dakord? Dakord.

Faleminderit!

Neni 67, “Vendimi dhe pasojat e rivendosjes në afat”, me shtesat dhe ndryshimet e bëra? Dakord? Dakord.

Pas nenit 67 shtohet seksioni i dytë, i titulluar “Llogaritja e afateve”. Dakord? Dakord.

Neni 68 “Llogaritja e afateve”, riformulohet sipas tekstit që keni përpara, për të cilën është rënë dakord nga grupi i punës, këshilltarët dhe Ministria e Drejtësisë. Dakord? Dakord.

Neni 69 “Prezumime për llogaritjen e afateve”. Në nenin 69, pika 1, shkronja “d”, në vijimësi të fjalisë së dytë shtohet fjalia si më poshtë vijon: “Ky komunikim nuk na sjell humbjen e afateve”. Dakord? Dakord.

Kreu VI “Kërkesat dhe paraqitja e saj, forma dhe përmbajtja e kërkesës”. Neni 70 mbetet siç është. Dakord?

Neni 71 “Paraqitja e kërkesës”, në pikën 3 pas togfjalëshit “pa vonesë kërkesën”, shtohet togfjalëshi “në çdo rast brenda 48 orëve nga paraqitja e saj”. Dakord me këtë ndryshim?

Dakord.

Faleminderit!

Nenit 72 i janë bërë disa shtesa dhe ndryshime, sipas tekstit që keni bashkëngjitur dhe që po e shqyrtojmë. Dakord? Dakord.

Neni 73 mbetet siç është. Dakord?

Neni 74, “Pasaktësitë në kërkesën e palës së interesuar për fillimin e procedimit administrativ”. Pas pikës 1, shtohen pikat 2, 3, 4 dhe 5 si vijon, siç i keni në tekst. Dakord? Dakord.

Në nenin 75 “Kërkesa verbale për fillimin e procedimit administrativ”, i formuluar sipas SIGMA-ës. Dakord? Dakord.

E njëjta gjë me sugjerim të SIGMA-s, neni 76 riformulohet, e shprehur kjo në tekstin që kemi në shqyrtim. Dakord? Dakord.

Gjithashtu, po me sugjerim të SIGMA-s dhe me dakordësinë e Ministrisë së Drejtësisë, neni 77 riformulohet siç është paraqitur në tekst. Dakord? Dakord.

Faleminderit!

Neni 78, KREU VII “Çështjet paraprake dhe vendimet e ndërmjetme”.

Neni 78, “Çështjet paraprake”, mbetet siç është.

Neni 79, “Vendimet e ndërmjetme”, mbetet siç është.

Neni 80 “Përfundimi i vendimeve të ndërmjetme”. Dakord siç është.

Kreu VIII “Vendimmarrja e përbashkët, pikat e shërbimit me një ndalesë, ndihma ndërmjet organeve publike dhe pajtimi”. Kreu VIII sugjerohet të vendoset te dispozitat mbi kompetencën, juridiksionin dhe delegimin dhe të titullohet “Organi publik, bashkëpunimi dhe ndihma” dhe në këtë kapitull të përfshihen nenet 81 dhe 84. Dakord? Dakord.

Në nenin 81 “Vendimmarrja e përbashkët e organeve publike”, neni 81 pika 3, pas fjalëve “njofton”, shtohet togfjalëshi “organ publik”. Në pikën 5 duhet të rivlerësohet referenca e përdorur pas rikonfigurimit të numrave të neneve dhe rinumërimit të tyre. Dakord?

Dakord.

Neni 84 spostohet pas nenit që vjen, pas nenit 81 me ndryshimin që bëme. Dakord? Dakord.

Faleminderit!

Neni 85 është vendosur këtu, sipas ndryshimit që bëme dhe do të rinumërohet kur të rinumërohet i gjithë teksti. Jeni dakord me ndryshimin e paraqitur?

Dakord.

Neni 86, “Procedura e ndihmës administrative”. Nuk ka numërtim procedura e ndihmës administrative? Dakord siç është.

Shtohet kapitulli me nëntitull “Pikat e shërbimit me një ndalesë”.

Neni 82 ndahet në tre nene dhe kemi përkatësisht:

Nenin 82 “Pikat e shërbimit me një ndalesë”. Dakord me ndryshimin e paraqitur?

Dakord.

Neni 83 “Përgjegjësitë e pikave të shërbimit me një ndalesë”. Dakord?

Dakord.

Neni 84 “Informimi dhe procedura”, me ndryshimin e bërë. Dakord?

Dakord.

Edhe një herë dua të saktësoj që numërtimet janë sa për efekt të kalimit të tekstit, por do të ketë një rinumërim për të reflektuar ndryshimet e bëra, për të qenë të saktë me procesverbalin.

Neni 83 “Kryerja e tërthortë e shërbimeve publike”, me ndryshimet që i janë bërë dhe sugjerimet që bëhen. Dakord? Dakord.

Neni 84 “Ndihma administrative” është spostuar më sipër. Dakord? Dakord.

Gjithashtu, neni 85 “Refuzimi i kërkesës për ndihmë administrative”, ka kaluar në kreun e mësipërm. Edhe neni 86 gjithashtu “Procedura e ndihmës administrative”. Dakord? Dakord.

Neni 87, “Pajtimi i palëve”, me ndryshimin e paraqitur. Dakord? Dakord.

Kalojmë te Kreu IX “Hetimi administrativ”. Neni 88 “Parimi i hetimit kryesisht”. Dakord?

Neni 89 mbetet siç është.

Neni 89 “Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ”, sugjerohet të ndryshohet. Dakord? Dakord.

Neni 90 “Subjektet e procedurës hetimore”, pika 3, fjala “ngarkoj” sugjerohet që të ndryshohet me fjalën “kërkoj” ose “delegoj”. Dakord? Dakord.

Seksioni 2, “Mjetet e kërkimit të provës”, është neni 91 “Kuptimi dhe mjetet e kërkimit të provës”. Është sugjeruar nga SIGMA të riformulohet neni 91 dhe Ministria e Drejtësisë është dakord me riformulimin e bërë nga SIGMA. Dakord.

Neni 92 “Vlerësimi i provave” mbetet siç është. Dakord?

Neni 93 “Barra e provës”, ka një sugjerim të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe pas pikës 1 të shtohet pika 2, sipas tekstit të paraqitur në draftin që kemi në shqyrtim dhe që ka në dispozicion secili nga kolegët. Dakord me këtë ndryshim? Dakord.

Faleminderit!

Neni 94 “Paraqitja e provave para një organi tjetër”, mbetet siç është.

Neni 95 “Metodat për paraqitjen e informacionit dhe provave”, me sugjerim të SIGMA-s, pika 2 hiqet, pasi ajo është përsëritje e paragrafit të parë të nenit 94.

Neni 95 riformulohet tërësisht sipas tekstit që keni për materialin në shqyrtim. Ministria e Drejtësisë është dakord. Me SIGMA-n kanë rënë dakord të gjithë? Dakord.

Faleminderit!

Neni 96: “mosparaqitja e provave”. Jeni dakord? Dakord.

Faleminderit!

Neni 97: “refuzimi i palës për bashkëpunim”. SIGMA sugjeron që neni 97 të hiqet. Për këtë bie dakord dhe Ministria e Drejtësisë si iniciuese e projektit.

Faleminderit!

Neni 98: “sigurimi i provave”. Pika 1 e këtij neni riformulohet sipas tekstit që keni në materialin në shqyrtim. Pika 2 dhe 3 mbeten siç janë. Jeni dakord? Dakord.

Faleminderit!

Neni 99: “paraqitja e parakohshme e provave”. SIGMA sugjeron që neni 99 të hiqet dhe Ministria e Drejtësisë ka rënë dakord me sugjerimin e bërë. Jeni dakord? Dakord.

Faleminderit!

Pastaj vazhdojmë me seksionin 3: “njoftimi dhe dëgjimi i palëve të interesuara”. Neni 100: “njoftimi dhe e drejta për t’u dëgjuar”. Neni 100 riformulohet. Biem dakord me riformulimin? Dakord.

Faleminderit!

Me sugjerim të SIGMA-s shtohet një nen i ri për lehtësi, 100, paragrafi 1, 100/1, por ne nuk po e numëtojmë për efekt të miratimit, por siç thamë do të riformatohen të gjitha numërtimet në versionin final. Është sugjerim i SIGMA-s: “kushte shtesë për një akt administrativ favorizues”. Gjithsesi duhet riparë dhe një herë. Ta konsiderojmë të kaluar.

Ketrin Treska – Jemi dakord me përfshirjen.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Faleminderit!

Neni 101: “ushtrimi i së drejtës për t’u dëgjuar” mbetet siç është.

Neni 102: “përjashtimi nga e drejta për t’u dëgjuar”. Jeni dakord.

Kreu 10: “Përfundimi i procedimit administrativ”.

Neni 103: “përfundimi i procedimit administrativ” ndryshohet sipas tekstit që keni në materialin e shpërndarë. Jeni dakord? Dakord.

Faleminderit!

Neni 104: “afati për përfundimin e procedimit administrativ”, bëhen shtesat dhe ndryshimet sipas tekstit të paraqitur. Jeni dakord? Dakord.

Faleminderit!

Neni 105: “zgjatja e afatit të procedimit” mbetet siç është.

Faleminderit!

Vendimi përfundimtar. Neni 106 sugjerohet të hiqet sepse krijon përsëritje me neni 103, pika 2 e po këtij projekti. Jeni dakord? Dakord.

Faleminderit!

Neni 107: “vdekja e palës”, mbarimi i personit juridik. Jeni dakord? Dakord.

Faleminderit!

Miratohet me ndryshimet e paraqitura.

Neni 108: “tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedimit” bëhen shtesat dhe ndryshimet sipas tekstit që kemi në shqyrtim. Jeni dakord? Dakord.

Faleminderit!

Neni 109: “pamundësia në objekt apo qëllim dhe braktisja”, bëhet riformulimi sipas tekstit të paraqitur. Jeni dakord? Dakord.

Faleminderit!

Neni 110: “mospagimi i tarifave” mbetet sipas tekstit origjinal. Jeni dakord.

Neni 111: “heshtja administrative”. Ky është një debat që besoj duhet ta kalojmë.

Po, zoti Subashi.

Armando Subashi – Në fakt neni 111 ka një moment pak delikat, do të thosha unë. Bën fjalë për heshtjen administrative, apo siç njihet ndryshe dhe miratimi me heshtje i një kërkesë nga organet e administratës. Në fakt nuk është vetëm ky, por është edhe një moment tjetër, ku do të vijmë pak më poshtë, te nenet e tjera që kanë të bëjnë me rishikimin administrativ. Në fakt janë të dyja këto momente. Janë dy parime po themi që ekspertët e SIGMA-s në bisedimet që kemi pasur këmbëngulin që të dyja këto duhet të parashikohen në Kodin e Procedurave Administrative. Unë në fakt do të doja që të kisha dhe vëmendjen e kolegëve të opozitës këtu, sepse sigurisht që duhet të jemi të kujdesshëm në këtë vendimarrje. Nuk është thjesht një moment teknik, por është diçka më shumë. Nëse do e pranojmë parimisht që një kërkesë drejtuar organeve administrative nuk shqyrtohet brenda një afati të caktuar, konsiderohet e miratuar, dakord, mund ta pranojmë Bëhet fjalë për çdo lloj kërkesë? Në cilin afat? A mundet që këtë ta lidhim edhe me ligjet e posaçme që

rregullojnë të themi atë të drejtë, apo atë fushë, apo atë veprimtari? Ky është një moment që meriton pak kujdes dhe që ndoshta do një diskutim profesional, jo politik, se nuk ka lidhje me vendimmarrje politike.

Dhe së dyti, ku do të vijë më pas, por që unë dua ta them këtu, ka të bëjë me rishikimin administrativ që prapë ekspertët e SIGMA-s këmbëngulin që edhe pse një organi administrativ i mëparshëm ka marrë një vendim, ka shqyrtuar një procedurë administrative, ka dalë me një vendim të caktuar, parashikohet që po i njëjti organ, sepse po të ishte një organ më i lartë, dakord, mund të ishte deri diku e pranueshme, por parashikohet që brenda një afati të caktuar, që mund të jetë një, dy apo tre vjet, me kërkesë apo qoftë edhe kryesisht i njëjti organ që ka dhënë vendimin mund ta rimarrë në shqyrtim, mund ta rishqyrtojë dhe sigurisht pastaj mundësitë janë të hapura në fund që mundet të marrin një vendim edhe të ndryshëm nga ai që mund të jetë marrë para një viti, para dy vjetësh apo para tre vjetësh. A jemi të gatshëm ne që ta pranojmë edhe këtë sugjerim? Sigurisht edhe këtu do të thosha se kërkohet pak vëmendje dhe ndoshta, kur të vijë momenti, duhet të jemi pak të kujdesshëm në këtë pikë.

Domethënë u bëra një lloj paraprite të dyja këtyre momenteve, sepse do të vijë dita që do të duhet të kemi një vendim këtu në këtë komision për këtë çështje dhe mirë është që ndoshta të dyja këto momente edhe nga kolegët e opozitës me ekspertët e vet që kanë ndoshta mund ta bëjnë një diskutim edhe këtu pastaj të jemi pak më në brendësi të çështjes. Por gjithsesi sot unë mendoj se është përpiluar një draft në këtë pikë, kolegët e kanë përpara. Le ta lëmë të hapur këtë çështje. Kur të vijë momenti, ta rimarrim në diskutim dhe për shqyrtim qoftë nenin 111, qoftë edhe atë që thashë, rishikimin administrativ.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Subashi!

Ka ndonjë koment tjetër? Po.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Te materiali i përgatitur nga relatori së bashku me ekspertët, shikoj që SIGMA ka paraqitur katër alternativa lidhur me këtë nen, që me të vërtetë është delikat dhe kërkon vëmendjen tonë si ligjvënës, dhe dy nga alternativat janë mundësia 3 dhe 4.

Pyetja për relatorin është: cila do të ishte e meta nëse ne do të pranonim alternativën e tretë, ose mundësinë e tretë ku thuhet që të ketë një dispozitë tranzitore që Republika e Shqipërisë do ta zbatojë këtë lloj dispozite kur të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian?

Dhe mundësia e katërt të mos përfshihet fare rregullimi i miratimit në heshtje në draftin e ri të Kodit të Procedurave Administrative.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Unë e falënderoj zonjën Hysi, por, mendoj se ne kemi rënë dakord që ta shqyrtojmë këtë kur të përmbyllet i gjithë procesi. Ka dy-tri dispozita, të cilat janë shumë të diskutueshme, jo sepse këto nuk qëndrojnë si institute në praktika ndërkombëtare, nuk është se nuk janë sot praktika që zbatohen, por duhet marrë parasysh momenti në të cilin gjendet administrata, momenti në të cilin gjendet jo nga pikëpamja e përbërjes, nga pikëpamja e mentalitetit, përvojës dhe efekteve që do të krijonte kjo në një proces gjykimi.

Ky është një diskutim që e bëjnë ekspertët me shumë të drejtë, është një diskutim aktiv, por unë mendoj që të mos japim përgjigje sot, sepse ne e kemi diskutuar këtë edhe me SIGMA-n, dhe vetë SIGMA nuk është shumë e bindur për këtë gjë, për shkak se është një standard që e zbatojnë në Gjermani, e zbatojnë në shumë vende të tjera, siç nuk e zbatojnë disa vende të tjera të ngjashme me ne.

Për këtë shkak, pak a shumë, për argumentet që kemi edhe ne këtu, për këtë dispozitë dhe dy-tri dispozitat e tjera, kemi rënë dakord që mbasi ta mbyllim tekstin ku dakordsohemi, të ulemi në një tavolinë debati, të shikojmë gjithë tekstin, sepse duke e parë si tekst të integruar do të krijojmë më shumë ide të qarta, më të plota, dhe. nga ana tjetër, të fokusohemi në 3-4 nene që kanë nevojë më shumë për diskutim dhe të vendosim bashkërisht si mund të bëhet më mirë.

Duhet të dimë një gjë, që Kodi i Procedurave Administrative, ashtu si çdo kod tjetër, por, për arsye që njihet shumë mirë nga kolegët, është një kod shumë i rëndësishëm, dhe ne nuk duhet të bëjmë asnjë gabim në këtë tekst, sepse mund të ketë efekte negative gjatë zbatimit e tij, prandaj po ecim me shumë kujdes.

Unë me këtë rast dëshiroj të falënderoj edhe një herë ekspertët e SIGMA-s për kontributin, punën dhe bashkëpunimin shumë të mirë që kemi pasur gjatë kësaj periudhe për t'i qartësuar më mirë qëndrimet e shprehura prej tyre!

Dëshiroj të falënderoj Ministrinë e Drejtësisë për bashkëpunimin e shprehur në procesin që jemi duke i bërë rishikimit të këtyre normave!

Pa dyshim, do të dëshiroja të vlerësoja këshilltaren e Kryeministrit, zonjën Met'hasani, dhe akoma më shumë dëshiroj të vlerësoj dhe të falënderoj këshilltarët e Kuvendit: Eridën, Almën,

Florin, të cilët kanë punuar së bashku me zonjën Met'hasani, me zonjat e nderuara të Ministrisë së Drejtësisë, me SIGMA-n!

Padyshim do të vlerësoja në mënyrë të veçantë, rolin e relatorit, kolegut tonë, zotit Subashi, i cili ka qenë pjesë aktive dhe nën drejtimin e tij është realizuar gjithë ky proces bashkëpunimi!

E ritheksoj, procesi i diskutimit të Kodit dhe miratimit të tij nuk është një proces bipartizan, nuk ka pse të ketë absolutisht tensione, qoftë këto individuale apo pozicionesh politike.

Unë besoj se në këtë pikë biem të gjithë dakord, nuk dua ta mendoj ndryshe dhe s'kam pse ta mendoj ndryshe, edhe nga praktika që kemi pasur ndër vite, për shkak edhe të faktit të natyrës dhe rëndësisë që ka ky ligj.

Por e ritheksoj edhe një herë për të qenë të qetë të gjithë kolegët, ne do ta kalojmë tekstin, duke punuar besoj vajtëm te nenet 110-111; ngelen, mos gabo, rreth 90 dispozita të tjera, të cilat grupi i punës që thashë, së bashku me relatorin, janë duke i riparë, duke i diskutuar.

Shpresoj që deri në fund të kësaj jave ky proces të mbyllet në tavolinë, në mënyrë që ne ta kalojmë pastaj draftin tërësisht dhe të mbeten ato pak dispozita që do të jenë pjesë e një tryeze debati në nivel ekspertësh që do të bëjmë së bashku me SIGMA-n, ku do të ftohen edhe kolegët për të qenë të pranishëm.

Kjo është pak a shumë përgjigja ndaj atij shqetësimi që u ngrit, por edhe një shpjegim për metodologjinë që do të duhet të ndjekim për këtë ligj. Mendoj që është metodologji e pranueshme dhe e justifikueshme për efekt të zgjatjes në kohë, në mënyrë që të kemi një produkt sa më cilësor dhe sa më pak të kontestuar, mundësisht, aspak të kontestuar gjatë zbatimit të tij në praktikë.

Jam i keqardhur për faktin se ata që do të duhej të shpreheshin për këtë më shumë se kushdo tjetër, gjyqtarët dhe Gjykata Administrative, megjithëse u është dhënë mundësia, nuk janë shprehur ose nuk kanë dashur, nuk kanë shprehur gatishmëri të përfshihen në këtë proces.

Jam realisht shumë i keqardhur për këtë fakt, përjashto disa opinione të sjella nga kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Dy shkallët e tjera, Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit Administrativ pothuajse nuk kanë dhënë asnjë opinion. Ose për ata nuk është e rëndësishme kjo gjë, është e rëndësishme një gjë tjetër që s'ka lidhje fare me drejtësinë, ose mesa duket nuk e njohin këtë, dhe e kanë të vështirë që të shprehen, por si njëra, si tjetra, është në kurriz të dhënies të drejtësisë. Por kjo është një çështje që nuk debatohet këtu, dhe nuk kemi pse e debatojmë këtu.

Kur të mbyllet ky proces, do t'u lutesha relatorit dhe këshilltarëve që t'ia ridërgojnë draftin çdo gjyqtari administrativ të Republikës së Shqipërisë.

Nëse ata e çmojnë, e kanë aftësinë apo zotësinë për t'u shprehur, le të shprehen. Ne si komision jemi të hapur që të dëgjojmë çdo lloj kontributi në interes të nevojës që kemi për të bërë një ligj më të mirë.

Jeni dakord me këtë gjë? Ka ndonjë njeri që nuk bie dakord?

Dakord, e mbyllim këtu.

(Diskutime pa mikrofon).

Nesër do të jetë projektligji “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me shpresën se është bërë gati, apo jo Klodi?

Dakord, le të shpresojmë, vërejtjet që bëri relatorja dhe zoti Halimi besoj do të jenë reflektuar nga ekspertët, ndërkohë do të biem dakord për vazhdimin e shqyrtimit të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, së bashku edhe me kolegët e opozitës, për të respektuar dhe atë çfarë u vendos në seancën e mëparshme.

E mbyllim sot këtu, edhe një herë, faleminderit për kontributin!

Mirë u takofshim nesër!

MBLEDHJA MBYLLET